VENDIM
Nr.729, datë 18.10.2006

PËR DHËNIEN ME QIRA, PA KONKURRIM, SHOQËRISË "UNIVERS-ALB" SHA, TIRANË, TË DISA MJEDISEVE NË SPITALIN USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 803 e 901 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien me qira, pa konkurrim, shoqërisë "Univers-Alb" sh.a., Tiranë, të disa mjediseve, me sipërfaqe trualli gjithsej 15 638 m^2 në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, Tiranë, institucion në varësi administrative të Ministrisë së Mbrojtjes, për ngritjen e një qendre spitalore.
2. Afati i kontratës së qirasë të jetë 20 (njëzet) vjet.
3. Autorizohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për lidhjen e kontratës së qirasë, sipas përcaktimeve të parashikuara në vendimin nr.315, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave "Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore".
4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha